

NDRYSHIME TË RREGULLAVE TË BASKETBOLLIT

Bordi Qëndror i FIBA-s në mbledhjen e tij më 25-26 Prill 2008 në Pekin, R.P e Kinës miratoi propozimet e Komisionit Teknik të FIBA-s për ndryshimet në Rregulloren Zyrtare të Basketbollit 2008 dhe 2010.

Ndryshimet në Rregullore 2008 hyjnë në fuqi që nga 1 Tetori 2008, ndërsa ato të 2010 hyjnë në fuqi gradualisht në 2010 dhe 2012.

Rregullorja Zyrtare e Basketbollit 2008 Përmbledhje e ndryshimeve kryesore

Art. 4.3 Uniformat

Shënimi që nën bluzë mund të vishet një bluzë në formë T nuk vlen me.

Art. 25.2.3 Lojtari që bie në fushë

Është e lejueshme për një lojtar me top të bjerë dhe të rëshqasë në fushë.

Art.28.1.3 Topi shkon në pjesën e përparme të fushës së skuadrës

Gjatë një driblimi nga pjesa e prapme në atë të përparme, topi shkon në pjesën e përparme kur të dy këmbët e dribluesit dhe topi janë në kontakt me pjesën e përparme.

Art. 30.1.2 Topi i kthyer në pjesën e prapme të fushës

Nuk do të jetë më shkelje nëse një lojtar që kërcen nga pjesa e përparme e fushës, hyn në një zotrim të ri të topit të skuadrës duke qënë në ajër dhe pastaj bie në pjesën e prapme të fushës.

Art. 31 Pengimi për shënim dhe ndërhyrja mbi topin

Nëse një lojtar zgjatet nëpërmjet shportës nga poshtë dhe arrin të prekë topin, kemi ndërhyrje (dhe jo shkelje të thjeshtë) me të gjitha pasojat që rrjedhin nga rregulla përkatëse.

Art. 36.1.4 Gabimi jospportiv

Nëse një lojtar mbrojtës në përpjekje për të ndaluar një sulm të shpejtë, prek një kundërshtar nga prapa ose anash dhe ndërmjet sulmuesit dhe shportës së kundërshtarëve nuk ka lojtar mbrojtës, prekja duhet gjykuar si jospportive.

Art. 38.3.1 Gabimi teknik

Ndaj një lojtari që bën një rrotullim jashtë mase të berrylave (pa prekje) do të jepet gabim teknik.